



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Letërsi dhe kulturë C

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë, 20 orë leksion, 20 orë seminar

Viti / Semestri: Viti I, semestri i I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Komunikim ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë: Të rritë aftësitë komunikuese në lëndën e letërsisë dhe të kulturës; Të realizojnë analiza mbi argumente të ndryshëm letrarë e kulturorë, psikologjikë, historikë, sociologjikë, etj. Të përmirësojë aftësitë komentuese përgjatë kërkimit shkencor, përgatitjes akademike dhe prezantimeve mbi tema të ndryshme të letërsisë, aktualitetit, kulturës, etnografisë, etj.. Të rritë aftësitë krahasuese, ndërsa zgjeron njohuritë për qasjet bashkëkohore;

Objektivat specifike lëndore:

1. T’u krijojë studentëve një panoramë të gjerë për kulturën dhe shoqërinë së vendit të gjuhës në studim, nëpërmjet studimit të pjesëve të shkurtra letrare, publicistike dhe të fushave të tjera.
2. Të prezantojë studentët shkurtimisht me rrymat kryesore letrare të këtyre vendeve, duke u përqendruar në aspektet kulturore të këtyre vendeve.
3. T’i njohë studentët me karakteristika të identitetit kombëtar e kulturor të këtyre vendeve, duke trajtuar në këtë kuadër edhe ndikimin e lëvizjeve të popullsisë
4. T’i njohë studentët me krijimin dhe zhvillimin e institucioneve kryesore social-politike në këto vende (politike, arsimore, sportive, kulturore e të tjera);

Rezultate të pritshme:

Të identifikojë dhe të analizojë elementët kryesorë të zhvillimit shoqëror, kulturor dhe letrar të vendeve gjuhët e të cilëve studiohen në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

Të interpretojë në mënyrë kritike materiale të ndryshme autentike (tekste letrare, artikuj, dokumentarë, intervista, etj.) që pasqyrojnë qytetërimin dhe kulturën e këtyre vendeve.

Të vlerësojë mënyrën se si kultura dhe letërsia shqiptare është perceptuar dhe trajtuar nga studiues dhe shkrimtarë të huaj në gjuhën që studenti studion.